

## FJALA E DEPUTETIT ILIR METAJ

E ENJTE 20 TETOR 2022

Një nga meritat e padiskutueshme të qeverisë socialiste është pa asnjë mëdyshje nxjerrja e Shqipërisë turistike nga rrënojat që e kishin mbuluar. Këtë gjë e filloi që ditën e parë të punës dhe e mbajti si devizë çdo ditë të mëpasshme.

Përse kjo këmbëngulje për të ndriçuar nga çdo kënd këtë profil të fshehur të Shqipërisë, pa hequr dorë asnjëherë, madje as atëherë kur na shkundi tërmeti, kur na mbuloi përmbytja, kur na mbylli pandemia apo kur po luftonim varfërinë? Pse kjo këmbëngulje edhe sot me këtë marrëveshje huaje, në një kohë kur kriza po kërcënon të gjithë Europën dhe kur gogoli i energjisë po na kërcënon në këtë prag dimri? Sepse ne nuk heqim dorë për asnjë moment nga projekti i një Shqipërie më të mirë, ndaj betejat e çdo dite nuk do të na lodhin asnjëherë, derisa të bëjmë kurban perspektivën.

Profili turistik i Shqipërisë është pjesë e rëndësishme e kësaj perspektive. Frytet duken sidomos në këto 2, 3 sezonet e fundit, madje duken përgjatë gjithë vitit nga Jugu në Veri. Turizmi është zhvillim i bazuar në krijimin e hapësirës për konsum. Si i tillë ai ka nevojë të paraprihet nga një zgjerim urban, duke diktuar në vijim transformimin e strukturave lokale, model të ri të përdorimit të tokës dhe lulëzimin e sektorëve terciarë. Pikërisht ky vizion ka sjellë tashmë për Vlorën një zinxhir zhvillimi ekonomik përmes konsumit dhe investimeve. E njëjta filozofi përshkoi planet rindërtuese të të gjitha qyteteve të Shqipërisë. Disa prej tyre janë në zhvillim e sipër, ndaj duhen mbështetur me financim. Është radha e Gjirokastrës, Sarandës, Beratit dhe Përmetit të ndjekin fatin e Vlorës. Kjo strategji urbanizimi nuk përfundon këtu, sepse nuk është spontane dhe as sporadike. Qeveria ka bërë të ditur se çdo qytet, nga Veriu në Jug, do të ketë profilin e tij turistik duke u bërë një xhevahir shqiptar në hartën e destinacioneve turistike ndërkombëtare. Në fakt, ky është trendi botëror. Meqenëse shpenzimet turistike për frymë të banorëve urbanë janë më të larta se ato të banorëve ruralë, konsiderohet se urbanizimi promovon dhe zhvillon turizmin.

Sot 55% e popullsisë së botës jeton në qytete dhe asetet kapitale i kanë të përqendruara në qytete, ndërkohë që projektohet që kjo shifër të shkojë në 70% në vitin 2050.

Turizmi urban po bëhet një forcë udhëheqëse ekonomike për Vlorën, Korçën, Tropojën, Pukën dhe shumë qytete të tjera, duke kontribuar në të ashtuquajturën “Agjenda e re urbane” dhe 17 objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Ndër ta, objektivi i 11-të është t’i bëjnë sot qytetet gjithëpërfshirëse, të sigurt, rezistente dhe të qëndrueshme. Ndaj, edhe turizmi shqiptar, si ai mbarëbotëror, duhet të integrohet në një agjendë më të gjerë të urbanizimit. Ky është fati. Mbështetur në këtë marrëveshje huaje për Gjirokastrën, Sarandën, Beratit dhe Përmetin, ky fat do të ndjekë me siguri edhe qytetet e tjera shqiptare, pastaj destinacioni i suksesit të këtij financimi është gjenerimi i burimeve për shlyerjen e tij. Turizmi është drejtpërdrejt i lidhur me mënyrën se si një qytet zhvillon veten dhe kushtet më të mira jetese për banorët e tij dhe për vizitorët. Ky proces përfshin të gjithë aktorët në disa nivele. Ai dikton bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet administratës lokale të turizmit, sektorit privat, komunitetit lokal dhe turistëve. Në konceptin tonë qytetet shqiptare i kanë të gjitha potencialet për të qenë një destinacion turistik, secili për arsye të ndryshme.

Turizmi bëhet kështu një funksion i rëndësishëm i urbanizimit, duke sjellë në këto qytete njerëzit, informacionin dhe paratë. Funksioni i këtyre qyteteve, si qendra kulturore dhe argëtuese, do të forcohet dhe motivimi për t'i bërë ato më atraktive për vizitorët do t'i bëjë të përmirësojnë vazhdimisht produktin turistik dhe imazhin.

Sot në Shqipëri, falë vizionit të patradhtuar asnjë ditë të qeverisë socialiste, marrëdhënia ndërmjet qytetit dhe turizmit po bëhet më e fortë. Qyteti është ena që mban turizmin dhe turizmi ushqehet nga zhvillimi urban, por urbanizimi për ne është më shumë se kaq. Ai ka merituar vëmendjen e veçantë të buxheteve socialiste, sidomos për shkak të rolit të pazëvendësueshëm që ka për transformimin e qyteteve në qytete të jetueshme. Për ne një qytet nuk konceptohet të jetë një vend atraktiv për turistët, por, së pari, për rezidentët lokalë, ndaj ka rëndësi respektimi i marrëdhënies midis turizmit urban dhe jetueshmërisë urbane, sepse për ne gjithçka duhet të jetë në funksion të jetës së shqiptarëve kudo ku ata kanë zgjedhur të jetojnë. Faleminderit!